



Datë: 11.12.2025

Numër Protokolli: 7848/2025

A.nr.1850/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1850/2025, të datës 29.10.2025, të parashtruar nga ankuesja L.P, kundër organit të punësimit: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 11.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1850/2025 e datës 29.10.2025, e parashtruar nga ankuesja L.P.

A r s y e t i m

Ankuesja, L.P (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), e punësuar në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, më datë 29.10.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7029/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.1850/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit, të Komisioni Disiplinor të Agjencisë Shtetërore të Arkivave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesja me datë 29.10.2025 është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh se ankuesja është e punësuar në Agjencinë Shtetërore të Arkivave në pozitën e punës “*Udhëheqëse e Arkivit Nder-komunal në Prizren*.”

Si rrjedhojë, ankuesja pas emërimit në pozitën e Udhëheqëses së Arkivit Nder komunal në Prizren, ka kërkuar nga nëpunësi H.H zyrtar për rregullimin e dokumentacionit arkivor , në arkivin nder komunal në Prizren që libri i protokollit të dorëzohet te zyrtaret e protokollit zyrtarja D.M e cila është e caktuar te kryej punët e protokollimit. Tutje me datë 09.09.2025 ankuesja kupton që librin e protokollit përsëri nga zyrtaret e protokollit ka marr nëpunësi H.H dhe në po të njëjtën ditë shkon në zyrën e nëpunësit H.H dhe e kërkon ndërsa ky i fundit refuzon dhe i kërkon të ja liroj zyrën ku i njëjti ankuesen e largon me forcë nga zyra. Ankuesja pas largimit nga zyra paraqitet në stacionin policor në Prizren për të dhënë deklaratën dhe me pas në spitalin rajonal të Prizrenit për trajtim.

Tutje me datë 10.09.25025 U.D Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ndaj nëpunësit H.H ka iniciuar procedurën disiplinore, pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datë 24.09.2025, 25.09.2025 dhe 30.09.2025 Komisioni disiplinorë në Agjencinë Shtetërore për Arkiva me datë 10.10.2025 përmes vendimit me numër 01/235/25 ka shqiptuar masën disiplinor transferim në pozitën e ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë për periudhë një (1) mujore në Arkivin Nder komunal të Gjakovës.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se Vendimi i komisionit Disiplinore, duke vendosur në rastin e nëpunësit H.H ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, në kuptim të asaj se Komisioni disiplinor gjatë zhvillimit të procedurës nuk e ka kualifikuar llojin e shkeljes disiplinore ashtu siç e përcakton Ligji për Zyrtar Publik.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se “Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t’i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i organi përkatës i punësimit në rastin konkret, rrjedhimisht me Vendimin me numër protokolli 01/235/25 të datës 10.10.2025, ankueses nuk i ka cenuar ndonjë të drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e saj të punës, andaj i njëjti nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.1850/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.**

Kështu që, për sa më sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1850/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses L.P;*
- *Udhëheqëses së Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës; si dhe,*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*